



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA FIER

Nr. 1105 Prot.

Fier, më 24.01.2025

Projekt - Vendim

Nr. 11 dt. 24.01.2025

“Për miratimin e vijimit të procedurës për dhënie me qira të pasurisë nr. 7/362 zk. 8531, lagja “1 Maj” Fier, pasurisë nr. 4/324 (nr. pasurisë në inventar 4/14) zk. 8534, pasurinë nr. 4/30-N2, 4/30-N5, 4/30-N6 dhe 4/30-N4 zk. 8534 lagja “Kastriot” Fier, në pronësi të Bashkisë Fier”

Këshillit të Bashkisë Fier sot më datë ____ .01.2025, i paraqitet për shqyrtim materiali i përgatitur nga Drejtoria e Menaxhimit të Pronave, bazuar në nenin 9 pika 1.2, neni 54, shkronja “e/1” të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, nenit 801-825 të K.Civil, VKM nr. 574 dt. 28.05.2009 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Fier, Qarku Fier” i ndryshuar dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 54 dt. 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore” i ndryshuar, Udhëzimit nr. 13, datë 26.04.2018, “Për zbatimin e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, të ndryshuar”, Vendim i Këshillit Bashkiak Fier nr. 131 dt. 26.11.2024 “Mbi strukturën dhe nivelin e taksave dhe tarifave vendore të vitit 2025”, **Kryetari i Bashkisë;**

Propozon:

1. Të miratojë vijimin e procedurës për dhënien me qira të pasurive nr. 7/362 zk. 8531, lagja “1 Maj” Fier, pasurisë nr. 4/324 (nr. pasurisë në inventar 4/14) zk. 8534, pasurinë nr. 4/30-N2, 4/30-N5, 4/30-N6 dhe 4/30-N4 zk. 8534 lagja “Kastriot” Fier, në pronësi të Bashkisë Fier.
2. Ngarkohet ekzekutivi për vijimin e mëtejshëm të procedurave administrativo – ligjore sipas përcaktimeve ligjore.

Drejtoria e Menaxhimit të Pronave

Drejtori: A. Behari

Drejtoria Juridike

Drejtoreshë: E. Kapllanaj

**NË MUNGESË DHE ME URDHËR
SEKRETAR I PËRGJITHSHËM
Martin DODI**

**KRYETARI
Armando SUBASHI**

